



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Kjësia: Uniti: Jedinita:	KO Nr. Prot.: Prot. No.: Br. Prot.: 31/2019
Nr. I faqeve: No. of pages: Dr. stranic:	-04- Data: Date: Datum: 17.12.2019
Prishtinë/s	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF 31/2019

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.12 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 22, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.12 dhe 1.14 dhe Nenit 53, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të OMK-së dhe Nenit 23, paragrafit 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 17 dhjetor 2019, nxjerrë këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË EKSPERTËVE QË KRYEJNË EKSPERTIZAT MJEKËSORE

Tarifat për ekspertët që kryejnë ekspertizat mjekësore me kërkesë të Gjykatave dhe Prokurorisë së Shtetit

- I. Të gjithë ekspertët mjekësor të emëruar me vendim të Kryetarit të OMK-së, për kryerjen e ekspertizave mjekësore të fushës penale sipas kërkesave të Gjykatave dhe Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës duhet të kompensohen sipas tarifave të përcaktuara si në vijim:
 - I.I Eksperti i vetëm i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kompensohet në shumë prej 100.00 (njëqind) € (euro);
 - I.II Eksperti i vetëm i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kur nga ai kërkohen ekzaminime shtesë, si ekzaminimi palës apo ekzaminime tjera mjekësore, kompensohet në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);
 - I.III Eksperti i cili është anëtar i komisionit të ekspertëve të emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kompensohet në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);
 - I.IV Eksperti i cili është anëtar i komisionit të ekspertëve të emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kur nga ai kërkohen ekzaminime shtesë, si ekzaminimi palës apo ekzaminime tjera mjekësore, kompensohet në shumë prej 200.00 (dyqind) € (euro);

II. Të gjithë ekspertët mjekësor të emëruar me vendim të Kryetarit të OMK-së, për kryerjen e ekspertizave mjekësore të fushës civile sipas kërkesave të Gjykatave dhe Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës duhet të kompensohen sipas tarifave të përcaktuara si në vijim :

II.I Eksperti i vetëm i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kompensohet në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);

II.II Eksperti i vetëm i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kur nga ai kërkohen ekzaminime shtesë, si ekzaminimi palës apo ekzaminime tjera mjekësore, kompensohet në shumë prej 200.00 (dyqind) € (euro);

II.III Eksperti i cili është anëtar i komisionit të ekspertëve të emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kompensohet në shumë prej 200.00 (dyqind) € (euro);

II.IV Eksperti i cili është anëtar i komisionit të ekspertëve të emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kur nga ai kërkohen ekzaminime shtesë, si ekzaminimi palës apo ekzaminime tjera mjekësore, kompensohet në shumë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) € (euro);

III. Të gjithë ekspertët mjekësor të emëruar me vendim të Kryetarit të OMK-së, për kryerjen e ekspertizave mjekësore të fushës civile dhe penale dhe pjesëmarrjes në seanca gjyqësore, sipas kërkesave të Gjykatave dhe Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës duhet të kompensohen sipas tarifave të përcaktuara si në vijim :

III.I Eksperti i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize të drejtëperdrejte ne seance gjyqësore, kompensohet në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);

III.II Eksperti i emëruar me Vendim për prezentimin e raportit te nje ekspertize kompensohet në shumë prej 100.00 (njëqind) € (euro);

Tarifat për ekspertët që kryejnë ekspertizat mjekësore me kërkesë të Inspektoratit të Shëndetësisë të Ministrisë së Shëndetësisë

I. Të gjithë ekspertët mjekësor të emëruar me vendim të Kryetarit të OMK-së, për kryerjen e ekspertizave mjekësore sipas kërkesave të Inspektoratit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë, duhet të kompensohen sipas tarifave të përcaktuara si në vijim :

I.I Eksperti i vetëm i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kompensohet në shumë prej 100.00 (njëqind) € (euro);

I.II Eksperti i vetëm i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kur nga ai kërkohen ekzaminime shtesë, si ekzaminimi palës apo ekzaminime tjera mjekësore, kompensohet në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);

I.III Eksperti i cili është anëtar i komisionit të ekspertëve të emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kompensohet në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);

I.IV Eksperti i cili është anëtar i komisionit të ekspertëve të emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kur nga ai kërkohen ekzaminime shtesë, si ekzaminimi palës apo ekzaminime tjera mjekësore, kompensohet në shumë prej 200.00 (dyqind) € (euro);

Tarifat për ekspertët që kryejnë ekspertizat mjekësore me kërkesë të palëve të treta (Kompani të Sigurimeve, Avokat të Licencuar, Palë në Procedura Gjyqësore,etj)

I. Të gjithë ekspertët mjekësor të emëruar me vendim të Kryetarit të OMK-së, për kryerjen e ekspertizave mjekësore sipas kërkesave të palëve të treta, duhet të kompensohen sipas tarifave të përcaktuara si në vijim :

I.I Eksperti i vetëm i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kompensohet në shumë prej 100.00 (njëqind) € (euro);

I.II Eksperti i vetëm i emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kur nga ai kërkohen ekzaminime shtesë, si ekzaminimi palës apo ekzaminime tjera mjekësore, kompensohet në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);

I.III Eksperti i cili është anëtar i komisionit të ekspertëve të emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kompensohet në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);

I.IV Eksperti i cili është anëtar i komisionit të ekspertëve të emëruar me Vendim për kryerjen e një ekspertize, kur nga ai kërkohen ekzaminime shtesë, si ekzaminimi palës apo ekzaminime tjera mjekësore, kompensohet në shumë prej 200.00 (dyqind) € (euro);

Zbatimi i tarifave për ekspertiza mjekësore

I. Kompensimi i tarifave për ekspertët mjekësorë për kryerjen e ekspertizave duhet të bëhet në llogarinë personale të secilit ekspert mjekësor, llogari të cilën e deklaron pas përfundimit të ekspertizës mjekësore.

II. Për çdo të dytin të dëmtuar të përfshirë në ekspertizat mjekësore, ekspertët mjekësor duhet të kompensohen me 50% shtesë të shumës së caktuar të tarifës sipas kërkesës për kryerjen e ekspertizës.

III. Kompensimi i ekspertëve mjekësor për kryerjen e ekspertizave duhet të bëhet jo më larg se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e dorëzimit apo ofrimit të ekspertizës mjekësore.

Hyrja në fuqi

- I. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i OMK-së.
- II. Ky vendim është i zbatueshëm për të gjitha kërkesat për emërim të ekspertëve mjekësor për kryerjen e ekspertizave mjekësore.
- III. Vendimi është i zbatueshëm nga data 1 Janar 2020.

Prishtinë, 17.12.2019

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci

